


PRISHTINË, PRILL 2021

# INTEGRITETI AKADEMIK, PUBLIKIMI SHKENCOR DHE JUSTIFIKIMI I TITUJVE AKADEMIKË NË UNIVERSITETIN E MITROVICËS



UNIVERSITETI  
I MITROVICËS





INTEGRITETI  
AKADEMIK,  
PUBLIKIMI  
SHKENCOR DHE  
JUSTIFIKIMI  
I TITUJVE  
AKADEMIKË NË  
UNIVERSITETIN E  
MITROVICËS

**Publikues:**

ORCA - Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim

**[www.orca-ks.org](http://www.orca-ks.org)**

[info@orca-ks.org](mailto:info@orca-ks.org)

Henrik Bariç, Nr. 6

Prishtina, 10000, Kosova

**Hulumtues:**

Liridona Ademaj

Skord Retkoceri

Saranda Sylejmani

**Autorë:**

Liridona Ademaj

Skord Retkoceri

**Design:**

Envinion



“Ati ynë që je në qiell, jepna fuqinë ta mbajmë  
gojën mbyllur kur s’kemi gjë për të thënë.  
Falna durimin të thellojmë një punë përpara  
se të shkruajmë mbi të! Frymëzoni me një  
ndjenjë të mprehtë të drejtësisë që të flasim jo  
vetëm me paanësi, por edhe të sillemi ashtu!  
Shpëtona nga grackat e gramatikës, nga  
shtrembërimet e gjuhës dhe nga lajthitjet e  
shtypit. Ashtu qoftë!”

[Faik Konica]

# TABELA E PËRMBAJTJES

Definime.....	7
HYRJE .....	8
Të dhëna të përgjithshme të universitetit .....	9
Pasqyra akademike e Universitetit të Mitrovicës .....	10
Numri i publikimeve shkencore në Universitetin e Mitrovicës..	10
Publikimi në revista të dyshimta .....	14
Justifikimi i titujve akademikë.....	15
Krahasimi me Universitetet e tjera publike.....	18
Fakulteti i Gjeoshkencave .....	19
Publikimi shkencor.....	19
Justifikimi i titujve akademikë.....	20
Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore.....	21
Publikimi shkencor.....	21
Justifikimi i titujve akademikë.....	22
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike.....	23
Publikimi shkencor.....	23
Justifikimi i titujve akademikë.....	24
Fakulteti Juridik .....	25
Publikimi shkencor.....	25
Justifikimi i titujve akademikë.....	26
Fakulteti Ekonomik.....	27
Publikimi shkencor.....	27
Justifikimi i titujve akademikë.....	28
Fakulteti i Edukimit.....	29
Publikimi shkencor.....	29
Justifikimi i titujve akademikë.....	30
Metodologjia .....	31

# DEFINIME

Punime të vlefshme për avancim – konsiderohen punimet e publikuara në revista siç është përcaktuar me ligjet dhe rregullativat për emërim, riemërim dhe avancim të stafit akademik.

Punime shkencore – punimet ku profesorët marrin pjesë si autorë pavarësisht renditjes, pra jo vetëm si autor i parë.

Punime në revista të dyshimta – punimet të cilat janë në revista apo në botues të listuar në listën Beall.

Justifikimi i titullit – të pasurit e numrit të nevojshëm të publikimeve shkencore për titullin përkatës sipas ligjeve dhe rregullativave në fuqi.

Burra dhe gra – Gjinia e presupozuar e personave në bazë të emrit pa paragjykuar identifikimin e tyre personal me njëri nga gjinitë apo me gjini të tjera jokonvencionale.

# HYRJE

ORCA po vazhdon të hulumtojë rreth integritetit akademik dhe publikimit shkencor në universitete publike meqenëse pjesa dërrmuese e fondeve vjen nga taksapaguesit. Pas publikimit të raporteve për Universitetin e Pejës, Universitetin e Prizrenit dhe të Gjakovës, në kuadër të projektit QAIN, ORCA ka kryer hulumtimin edhe për Universitetin e Mitrovicës.

Raporti është rezultat i punës hulumtuese gjatë periudhës kohore janar-shkurt 2021, ku hulumtuesit e ORCA-s shqyrtuan materialet e publikuara në CV-të e stafit akademik të Universitetit të Mitrovicës me titujt profesorial: profesor asistent, profesor i asocuar dhe profesor i rregullt.

Përveç CV-ve janë hulumtuar edhe dokumente të tjera në uebfaqe të universitetit të cilat listojnë publikimet shkencore të profesorëve.

Universiteti i Mitrovicës e ka të publikuar një rubrikë në faqen zyrtare të saj të quajtur 'Hulumtime shkencore', në të cilën gjendet një përmbledhje e punës shkencore të stafit akademik e ndarë në katër kategori. Punime të listuara në Google Scholar, Punime Shkencore, Konferenca Shkencore dhe Revista Shkencore.

Ngjashëm me universitetet e tjera publike por dukshëm në përqindje më të vogël, 48% e profesorëve në këtë universitet nuk i justifikojnë titujt e tyre akademikë. Për krahasim, mosjustifikimi i titujve për vitin 2020 në Universitetin e Gjakovës është 65%, ndërkohë që gjatë vitit 2019, mosjustifikimi i titujve në Universitetin e Prishtinës ishte 55%, në Universitetin e Prizrenit ishte 64% dhe në Universitetin e Pejës ishte 70%.

Numri total i publikimeve në Universitetin e Mitrovicës është 256. Fakulteti me më së shumti punime në revista shkencore është Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore. Numri total i punimeve në këtë fakultet është 78, me mesatarisht 5.2 punime për kokë profesori. Mirëpo Fakulteti i Edukimit ka më së shumti punime për kokë profesori, me mesatarisht 6.20 punime.

Ndërkohë që fakulteti me më së paku punime të botuara në revista shkencore është Fakulteti Ekonomik me 29 punime të evidentuara. Mirëpo fakulteti me më së paku punime për kokë profesori është Fakulteti i Gjeoshkencave, me mesatarisht 2.26 punime. Një analizë e tillë mund të jetë e dobishme në planifikimin e reformave, përfshirë këtu edhe financimin e projekteve shkencore ashtu që të ketë rritje të publikimit shkencor në këtë universitet.



# TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

## BUXHETI

Nga thesari i buxhetit të Kosovës, për Universitetin e Mitrovicës (UMIB), janë ndarë gjithsej 4 milionë e 788 mijë e 969 euro vetëm për vitin 2019, ndërsa për vitin 2020, janë ndarë 3 milionë e 886 mijë e 978 euro, sipas gjetjeve në raportin e fundit për financa të publikuar nga ORCA<sup>1</sup>, në tetor të vitit 2020.

## STUDENTËT

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës<sup>2</sup>, Universiteti i Mitrovicës në nivelin Bachelor ka gjithsej 1 mijë e 660 studentë. Në nivelin Master, janë gjithsej 152 studentë, ndërsa nuk ka programe të nivelit të doktoratës.

Në nivelin Bachelor, janë gjithsej 1 mijë e 126 femra dhe 534 meshkuj. Ndërkaq sa i përket numrit të studentëve të diplomuar në vitin akademik 2019/2020, janë gjithsej 140 femra dhe 96 meshkuj, pra 259 të diplomuar. Raporti student-mësimdhënës në këtë universitet është 14:1.

## TRANSPARENCA FORMALE

Në faqen zyrtare të Universitetit të Mitrovicës, në shtator të vitit 2020, ORCA kishte gjetur se janë të publikuara gjithsej 25 nga gjithsej 27 dokumente apo informacione bazike rreth funksionimit të universitetit<sup>3</sup>. Kjo shënon rritje nga matja e parë e bërë në shkurt të vitit 2019 kur kishte vetëm 15 dokumente publike.

<sup>1</sup> Raporti "Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës: Menaxhimi i Financave", 2020, linku: <http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2020/10/Menaxhimi-i-financave-2.pdf>

<sup>2</sup> Statistikat e arsimit në Kosovë 2019/20, qershor 2020, linku: <https://ask.rks-gov.net/media/5636/arsimi-201920120-shqip.pdf>

<sup>3</sup> Raporti "Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës: (Mos)informimi i publikut", 2020, linku: <http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2020/10/Mosinformimi-i-Publikut-2.pdf>

# PASQYRA AKADEMIKE E UNIVERSITETIT TË MITROVICËS

Universiteti i Mitrovicës ka 71 profesorë që janë evidentuar përmes CV-ve të publikuara në uebfaqen e universitetit. Prej tyre 15 janë gra (21%) dhe 56 janë burra (79%). 22 janë profesorë të rregullt, 19 janë profesorë të asocuar dhe 30 janë profesorë asistentë.


## NUMRI I PUBLIKIMEVE SHKENCORE NË UNIVERSITETIN E MITROVICËS

Bazuar në CV-të dhe dokumentet tjera të publikuara në uebfaqe të universitetit, profesorët e Universitetit të Mitrovicës kanë publikuar në total 256 punime. Numri i punimeve të vlefshme për avancim akademik pra si autor i parë është 161.

Ndërkaq numri i punimeve ku kanë marrë pjesë edhe profesorët që nuk janë autor i parë është 90.

Nga 71 profesorë të Universitetit të Mitrovicës, 23 apo 32% nuk kanë asnjë punim të publikuar si autor i parë. Për vitin 2020, në Universitetin e Gjakovës janë 14 apo 54% profesorë që nuk kanë asnjë punim të botuar. Ndërkohë që për vitin 2019, në Universitetin e Prishtinës ishin 186 apo 39%, në Universitetin e Prizrenit ishin 31 apo 55% dhe në Universitetin e Pejës ishin 22 apo 66%.

## NUMRI I PUBLIKIMEVE NË UNIVERSITETIN E MITROVICËS PËRGJATË VITEVE



Fakulteti me më së shumti punime në revista shkencore në Universitetin e Mitrovicës është Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore. Numri total i punimeve në këtë fakultet është 78 me mesatarisht 5.2 punime për kokë profesori. Mirëpo Fakulteti i Edukimit ka më së shumti punime për kokë profesori, me mesatarisht 6.20 punime.

Krahasimisht, fakulteti me më së shumti punime nga të dhënat e mbledhura për vitin 2020, në Universitetin e Gjakovës është Fakulteti i Mjekësisë. Numri total i punimeve në këtë fakultet është 66 me mesatarisht 9.4 punime për kokë profesori.

Ndërkohë që fakulteti me më së paku punime të botuara në revista shkencore në Universitetin e Mitrovicës është Fakulteti Ekonomik me 29 punime të evidentuara. Mirëpo fakulteti me më së paku punime për kokë profesori është Fakulteti i Gjeoshkencave, me mesatarisht 2.26 punime.

### PUBLIKIMET SHKENCORE PËR PROFESOR

Nr.	Fakultetet në Universitetin e Mitrovicës	Numri total i publikimeve	Numri total i profesorëve	Punime për profesor
1	Fakulteti i Gjeoshkencave	52	23	2.26
2	Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore	78	15	5.20
3	Fakulteti i Inxhinierisë Me-kanike dhe Kompjuterike	36	13	2.77
4	Fakulteti Juridik	30	9	3.33
5	Fakulteti Ekonomik	29	6	4.83
6	Fakulteti i Edukimit	31	5	6.20
<b>TOTAL</b>		<b>256</b>	<b>71</b>	<b>3.61</b>

Mesatarja e punimeve në nivel universiteti është 3.61 punime për profesor.

Për krahasim, në të dhënat e mbledhura për vitin 2020, në Universitetin e Gjakovës janë 3.65 punime për profesor. Ndërkohë që nga të dhënat e mbledhura për vitin 2019, në Universitetin e Prishtinës ishin 4.26 punime për profesor dhe në Universitetin e Prizrenit ishin 1.17 punime.

Nga 71 profesorë sa ka Universiteti i Mitrovicës, 23 apo 32% janë pa asnjë punim shkencor. Fakulteti me më së shumti profesorë pa punime shkencore është Fakulteti i Gjeoshkencave me 10 profesorë. Ndërsa përqindjen më të madhe të profesorëve pa asnjë punim shkencor e ka Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike me 46%. Ndërkohë që fakulteti që nuk ka asnjë profesorë pa punime shkencore nga 9 sa ka gjithsej është Fakulteti Juridik.

## STAFI AKADEMIK PA ASNJË PUNIM SHKENCOR

Nr.	Fakultetet në Universitetin e Mitrovicës	Numri i profesorëve pa asnjë punim shkencor	Numri total i profesorëve
1	Fakulteti i Gjeoshkencave	10 (43%)	23
2	Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore	5 (33%)	15
3	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike	6 (46%)	13
4	Fakulteti Juridik	0 (0%)	9
5	Fakulteti Ekonomik	1 (17%)	6
6	Fakulteti i Edukimit	1 (20%)	5
<b>TOTAL</b>		<b>23</b> (32%)	<b>71</b>

## PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA


Nga 71 profesorët e Universitetit të Mitrovicës, 56 apo 78% kanë publikuar në revista të dyshimta. Numri i punimeve të tilla në nivel universiteti është 391. Fakulteti me më së shumti publikime në revista të dyshimta është Fakulteti i Gjeoshkencave me 178 sosh. Për krahasim, nga numri total i profesorëve, publikimi në revista të dyshimta në Universitetin e Gjakovës për vitin 2020 është 58%. Ndërkaq për vitin 2019, në Universitetin e Prishtinës publikimi në revista të dyshimta ishte 32%, në Universitetin e Pejës ishte 45%, dhe në Universitetin e Prizrenit publikimi në revista të dyshimta ishte 66%.

### PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA

Nr.	Fakultetet në Universitetin e Mitrovicës	Numri i publikimeve në revista të dyshimta	Numri i profesorëve që publikuan në revista të dyshimta
1	Fakulteti i Gjeoshkencave	178	19
2	Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore	139	13
3	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike	32	9
4	Fakulteti Juridik	6	4
5	Fakulteti Ekonomik	22	6
6	Fakulteti i Edukimit	14	5
<b>TOTAL</b>		<b>391</b>	<b>56</b>

Vitet 2013 dhe 2016 janë vitet me më së shumti publikime në revista të dyshimta, me nga 60 punime. Ndërsa nga viti 2017 e tutje ka rënie drastike të publikimeve në revista të tilla deri në 8 punime në vitin 2020, gjë që përbën përmirësim të dukshëm nga ana e profesorëve të këtij universiteti.


## PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA



## JUSTIFIKIMI I TITUJVE AKADEMIKË

Nga 71 profesorë në Universitetin e Mitrovicës, 34 apo 48% nuk i justifikojnë titujt akademikë sipas kriterit të punimeve shkencore si autor i parë. Për krahasim, mosjustifikimi i titujve në vitin 2020 në Universitetin e Gjakovës është 65%, ndërkohë që mosjustifikimi i titujve për vitin 2019 në Universitetin e Prishtinës ishte 55%, në Universitetin e Prizrenit ishte 64%, dhe në Universitetin e Pejës ishte 70%.

Nga 30 profesorët asistentë, 5 prej tyre nuk i justifikojnë titujt akademikë. Tek profesorët e asocuar, mosjustifikimi i titujve është 10 nga 19 profesorë të asocuar gjithsej. Ndërsa tek profesorët e rregullt në këtë universitet, 19 nga 22 nuk i justifikojnë titujt. Sa më i lartë titulli akademik, aq më e madhe mundësia që profesori nuk e justifikon titullin akademik.

JUSTIFIKIMI I TITUJVE NË  
UNIVERSITETIN E MITROVICËS


Nga 71 profesorë sa ka gjithsej Universiteti i Mitrovicës, 34 apo 48 % e tyre nuk i justifikojnë titujt akademikë ndërsa 37 apo 52% e tyre i justifikojnë. Fakulteti me më së shumti profesorë që nuk i justifikojnë titujt e tyre akademikë është Fakulteti i Gjeoshkencave me 17 apo 74% të profesorëve nga 23 sa ka gjithsej. Ndërkohë që fakultetet që kanë më së paku profesorë që nuk i justifikojnë titujt e tyre akademikë janë Fakulteti Juridik dhe Fakulteti Ekonomik me vetëm nga një profesor, nga 9 sa ka gjithsej Fakulteti Juridik dhe nga 6 sa ka gjithsej Fakulteti Ekonomik.

## JUSTIFIKIMI I TITUJVE AKADEMIKË SIPAS FAKULTETEVE

Nr.	Fakultetet në Universitetin e Mitrovicës	Të gjithë profesorët	
		✓	✗
1	Fakulteti i Gjeoshkencave	6 (26%)	17 (74%)
2	Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore	8 (53%)	7 (47%)
3	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike	7 (54%)	6 (46%)
4	Fakulteti Juridik	8 (89%)	1 (11%)
5	Fakulteti Ekonomik	5 (83%)	1 (17%)
6	Fakulteti i Edukimit	3 (60%)	2 (40%)
<b>TOTAL</b>		<b>37 (52%)</b>	<b>34 (48%)</b>



Sa i përket justifikimit sipas titujve akademikë, 86 % e profesorëve të rregullt nuk i justifikojnë titujt e tyre akademikë ndërsa 14% e tyre i justifikojnë.

53% e profesorëve të asocuar nuk i justifikojnë titujt akademikë ndërsa 47% e tyre i justifikojnë.

17% e profesorëve asistencë nuk i justifikojnë titujt e tyre akademikë ndërkohë që 83% e tyre i justifikojnë.

## JUSTIFIKIMI SIPAS TITUJVE AKADEMIKË

Nr.	Fakultetet në Universitetin e Mitrovicës	Profesorët asistentë		Profesorët e asocuar		Profesorët e rregullt	
		✓	✗	✓	✗	✓	✗
1	Fakulteti i Gjeoshkencave	3	1	2	5	1	11
2	Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore	3	0	3	4	2	3
3	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike	7	3	0	0	0	3
4	Fakulteti Juridik	7	0	1	1	0	0
5	Fakulteti Ekonomik	2	0	3	0	0	1
6	Fakulteti i Edukimit	3	1	0	0	0	1
<b>TOTAL</b>		25	5	9	10	3	19
		(83%)	(17%)	(47%)	(53%)	(14%)	(86%)

## KRAHASIMI ME UNIVERSITETET E TJERA PUBLIKE

Përqindja e profesorëve pa asnjë punim gjatë vitit 2020, në Universitetin e Mitrovicës doli të jetë 32%, në Universitetin e Gjakovës është 54%, ndërkohë gjatë vitit 2019, kjo mesatare e punimeve në Universitetin e Prishtinës ishte 39%, në Universitetin e Prizrenit ishte 55% dhe në Universitetin e Pejës ishte 66%.

Gjatë vitit 2020, përqindja e mosjustifikimit të titujve në Universitetin e Mitrovicës rezultoi të jetë 48%, në Universitetin e Gjakovës është 65%, ndërkohë që për vitin 2019, në Universitetin e Prishtinës ishte 55%, në Universitetin e Prizrenit ishte 64% dhe në Universitetin e Pejës ishte 70%.

Kur jemi tek profesorët që kanë publikuar në revista të dyshimta, për të dhënat nga viti 2020, Universiteti i Mitrovicës ka 78% të profesorëve, në Universitetin e Gjakovës janë 58%, ndërkohë për vitin 2019, në Universitetin e Prishtinës ishin 32% e profesorëve, në Universitetin e Prizrenit ishin 66% dhe në Universitetin e Pejës ishin 45%.

### KRAHASIMI ME UNIVERSITETET E TJERA PUBLIKE

Universiteti	Përqindja e profesorëve pa asnjë punim	Përqindja e mosjustifikimit të titujve	Përqindja e profesorëve që kanë publikuar në revista të dyshimta
Universiteti i Mitrovicës	32%	48%	78%
Universiteti i Gjakovës*	54%	65%	58%
Universiteti i Prishtinës**	39%	55%	32%
Universiteti i Prizrenit**	55%	64%	66%
Universiteti i Pejës**	66%	70%	45%

Sqarim i fusnotave:

\* Të dhënat për vitin 2020

\*\* Të dhënat për vitin 2019

# FAKULTETI I GJEOSHKENCAVE




**23** profesorë me tituj akademikë  
**12** profesor i rregullt  
**7** profesorë të asocuar  
**4** profesorë asistentë

## PUBLIKIMI SHKENCOR


Profesorët në Fakultetin e Gjeoshkencave kanë publikuar në total 52 punime në revista shkencore. Prej tyre 30 janë të vlefshme për avancim akademik, pra si autor i parë. 10 profesorë në këtë fakultet nuk kanë asnjë punim të publikuar si autor i parë.

### PUBLIKIMI SHKENCOR NË FAKULTETIN E GJEOSHKENCAVE



19 profesorë kanë botuar 178 punime në revista të dyshimta. Viti 2013 shënon vitin me më së shumti punime në revista të tilla, me 38 sosh. Në vitet në vijim ka rënie, deri në vitin 2016 ku janë botuar 24 të tilla, ndërkohë që viteve në vazhdim kishte përsëri rënie deri në vitin 2020 është vetëm një.

### PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA



## JUSTIFIKIMI I TITUJVE AKADEMIKË

Prej 23 profesorëve, 17 apo 74% nuk i justifikojnë titujt akademikë sa i përket kriterit për publikime në revista shkencore si autor i parë. Nga 4 profesorët asistentë, 1 prej tyre nuk e justifikon titullin akademik. Nga 7 profesorët e asocuar, 5 prej tyre nuk i justifikojnë titujt. Nga 12 profesorët e rregullt, 11 nuk e justifikojnë titullin akademik.

Profesorët asistentë		Profesorët e asocuar		Profesorët e rregullt		Total	
✓	✗	✓	✗	✓	✗	✓	✗
3	1	2	5	1	11	6 (26%)	17 (74%)

# FAKULTETI I TEKNOLOGJISË USHQIMORE




**15** profesorë me tituj akademikë  
**5** profesor i rregullt  
**7** profesorë të asocuar  
**3** profesorë asistentë

## PUBLIKIMI SHKENCOR


Profesorët në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore kanë publikuar në total 78 punime në revista shkencore. Prej tyre 43 janë të vlefshme për avancim akademik, pra si autor i parë. Viti 2020 është viti me më së shumti punime, me 11 sosh. Pesë profesorë në këtë fakultet nuk kanë asnjë punim të publikuar si autor i parë.

### PUBLIKIMI SHKENCOR NË FAKULTETIN E TEKNOLOGJISË USHQIMORE



13 profesorë kanë botuar 139 punime në revista të dyshimta. Më së shumti punime të tilla ka në vitin 2016, me 32 të tilla. Në vitet në vijim kryesisht ka rënie, deri në vitin 2019 ku janë botuar 14 të tilla.

## PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA



## JUSTIFIKIMI I TITUJVE AKADEMIKË

Prej 15 profesorëve të Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore, 7 apo 47% nuk i justifikojnë titujt akademikë sa i përket kriterit për publikime në revista shkencore si autor i parë. Nga 3 profesorët asistentë, të gjithë e justifikojnë titullin akademik. Nga 7 profesorët e asocuar, 4 nuk e justifikojnë titullin. Nga 5 profesorët e rregullt, 3 nuk e justifikojnë titullin akademik.

Profesorët asistentë		Profesorët e asocuar		Profesorët e rregullt		Total	
✓	✗	✓	✗	✓	✗	✓	✗
3	0	3	4	2	3	8 (53%)	7 (47%)

# FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE DHE KOMPJUTERIKE




**13** profesorë me tituj akademikë  
**3** profesorë të asocuar  
**10** profesorë asistentë

## PUBLIKIMI SHKENCOR


Profesorët në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike kanë publikuar 36 punime në revista shkencore, të vlefshme për avancim akademik. Viti 2020 është viti me më së shumti punime, me 7 sosh. 6 profesorë në këtë fakultet nuk kanë asnjë punim të publikuar si autor i parë.

### PUBLIKIMI SHKENCOR NË FAKULTETIN E INXHINIERISË MEKANIKE DHE KOMPJUTERIKE



9 profesorë kanë botuar 32 punime në revista të dyshimta. Viti 2017 shënon vitin me më së shumti punime të tilla, me 10 sosh. Në vitet në vijim ka rënie, deri në vitin 2020 ku është botuar vetëm një.

### PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA



## JUSTIFIKIMI I TITUJVE AKADEMIKË

Prej 13 profesorëve, 6 apo 46% nuk i justifikojnë titujt akademikë sa i përket kriterit për publikime në revista shkencore si autor i parë.

Nga 10 profesorët asistentë, 3 prej tyre nuk e justifikojnë titullin akademik. Nuk ka profesor të asocuar. Asnjë prej 3 profesorëve të rregullt nuk e justifikojnë titullin.

Profesorët asistentë		Profesorët e asocuar		Profesorët e rregullt		Total	
✓	✗	✓	✗	✓	✗	✓	✗
7	3	0	0	0	3	7 (54%)	6 (46%)



# FAKULTETI JURIDIK




**9** profesorë me tituj akademikë  
**2** profesorë të asocuar  
**7** profesorë asistentë

## PUBLIKIMI SHKENCOR

Profesorët në Fakultetin Juridik kanë publikuar në total 30 punime në revista shkencore. Prej tyre 21 janë të vlefshme për avancim akademik, pra si autor i parë.


Nuk ka profesorë në këtë fakultet që nuk kanë asnjë punim të publikuar si autor i parë.

### PUBLIKIMI NË REVISTA ME KOEFICIENT



4 profesorë kanë botuar 6 punime në revista të dyshimta. Viti 2015 shënon vitin me më së shumti punime në revista të tilla, me 3 sosh. Në vitet në vijim ka rënie, ku janë botuar vetëm nga një.

### PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA



## JUSTIFIKIMI I TITUJVE AKADEMIKË

Prej 9 profesorëve, 1 apo 11% nuk i justifikojnë titujt akademikë sa i përket kriterit për publikime në revista shkencore si autor i parë.

Nga 7 profesorët asistentë, të gjithë e justifikojnë titullin akademik. Nga 2 profesorët e asocuar, 1 prej tyre nuk e justifikon titullin. Nuk ka profesorë të rregullt.

Profesorët asistentë		Profesorët e asocuar		Profesorët e rregullt		Total	
✓	✗	✓	✗	✓	✗	✓	✗
7	0	1	1	0	0	8 (89%)	1 (11%)

# FAKULTETI EKONOMIK




- 6** profesorë me tituj akademikë
- 1** profesor i rregullt
- 3** profesorë të asocuar
- 2** profesorë asistentë

## PUBLIKIMI SHKENCOR


Profesorët në Fakultetin Ekonomik kanë publikuar në total 29 punime në revista shkencore. Prej tyre 19 janë të vlefshme për avancim akademik, pra si autor i parë. 1 profesor në këtë fakultet nuk ka asnjë punim të publikuar si autor i parë.

### PUBLIKIMI SHKENCOR NË FAKULTETIN EKONOMIK



6 profesorë kanë botuar 22 punime në revista të dyshimta. Viti 2018 shënon vitin me më së shumti punime në revista të tilla, me 6 sosh. Në vitet në vijim ka rënie, deri në vitin 2020 ku janë botuar 2 të tilla.

### PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA



## JUSTIFIKIMI I TITUJVE AKADEMIKË

Prej 6 profesorëve, 1 apo 17% nuk i justifikojnë titujt akademikë sa i përket kriterit për publikime në revista shkencore si autor i parë.

Të dy profesorët asistentë, e justifikojnë titullin e tyre akademik. Tre profesorët e asocuar, i justifikojnë titujt. Një profesor i rregullt, nuk e justifikon titullin akademik.

Profesorët asistentë		Profesorët e asocuar		Profesorët e rregullt		Total	
✓	✗	✓	✗	✓	✗	✓	✗
2	0	3	0	0	1	5 (83%)	1 (17%)

# FAKULTETI I EDUKIMIT




**5** profesorë me tituj akademikë  
**1** profesor të asocuar  
**4** profesorë asistentë

## PUBLIKIMI SHKENCOR


Profesorët në Fakultetin e Edukimit kanë publikuar në total 31 punime në revista shkencore. Prej tyre 8 janë të vlefshme për avancim akademik, pra si autor i parë. 1 profesor në këtë fakultet nuk ka asnjë punim të publikuar si autor i parë.

### PUBLIKIMI SHKENCOR NË FAKULTETIN E EDUKIMIT



5 profesorë kanë botuar 14 punime në revista të dyshimta. Viti 2013 shënon vitin me më së shumti punime në revista të tilla, me 4 sosh. Në vitet në vijim ka rënie, deri në vitin 2020 ku janë botuar 3 të tilla.

## PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA



## JUSTIFIKIMI I TITUJVE AKADEMIKË

Prej 5 profesorëve, 2 apo 40% nuk i justifikojnë titujt akademikë sa i përket kriterit për publikime në revista shkencore si autor i parë.

Nga 4 profesorët asistentë, 1 prej tyre nuk e justifikon titullin akademik. Nuk ka profesorë të asocuar. Profesori i vetëm me titullin i rregullt, nuk e justifikon titullin akademik.

Profesorët asistentë		Profesorët e asocuar		Profesorët e rregullt		Total	
✓	✗	✓	✗	✓	✗	✓	✗
3	1	0	0	0	1	3 (60%)	2 (40%)

# METODOLOGJIA

## Baza ligjore

- ① Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës<sup>4</sup>
- ② Statuti i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, gjegjësisht Nenet 168, 169 dhe 170<sup>5</sup>
- ③ Udhëzimi Administrativ 01/2018 Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension<sup>6</sup>
- ④ Udhëzimi Administrativ për plotësimin dhe precizimin – (Aneksi –I- MASHT) 7/2018 e Udhëzimit Administrativ 01/2018 Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension.<sup>7</sup>
- ⑤ Rregullore për procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes, avancimit dhe emërimit të personelit akademik në Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini”<sup>8</sup>

ORCA ka bërë shqyrtimin e publikimeve në revista shkencore ndërkombëtare, të përcaktuara si kriter nga Ligji për Arsimin e Lartë në Kosovë, Statutin e Universitetit të Mitrovicës për zgjedhje në njërin nga titujt akademikë: profesor asistent, profesor i asocuar apo profesor i rregullt, Udhëzimet Administrative 01/2018 dhe 07/2018, si dhe Rregullorja për procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes, avancimit dhe emërimit të personelit akademik në Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini”.

4 Ligji për arsimin e lartë, 2011, linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2761>

5 Statuti i Universitetit publik të Mitrovicës, 2020, linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=35866>

6 Udhëzimi Administrativ 01/2018 Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension, 2018, linku: <http://masht.rks-gov.net/uploads/2018/01/ua-nr-01-2018-parimet-e-njohjes-se-platoformave-dhe-revistave-nderkombetare-me-recension.pdf>

7 Udhëzimi Administrativ për plotësimin dhe precizimin – (Aneksi –I- MASHT) 7/2018 e Udhëzimit Administrativ 01/2018 Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension, 2018, linku: [http://masht.rks-gov.net/uploads/2018/05/ua-7-2018-per-plotesimin-dhe-precizimin-e-ua-parimet-e-njohjes-per-revistat-nderkombetare\\_1.pdf](http://masht.rks-gov.net/uploads/2018/05/ua-7-2018-per-plotesimin-dhe-precizimin-e-ua-parimet-e-njohjes-per-revistat-nderkombetare_1.pdf)

8 Rregullore për procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes, avancimit dhe emërimit të personelit akademik në Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini”, 2018, linku: <http://umib.net/wp-content/uploads/2018/09/rregullorja673.pdf>

## OBJEKTI I SHQYRTIMIT

Janë shqyrtuar CV-të e 71 anëtarëve të stafit profesorial në 6 fakultetet e Universitetit të Mitrovicës. Këtu nuk përfshihen asistentët, ligjëruesit, lektorët dhe bashkëpunëtorët e tjerë të cilët nuk i kanë titujt akademikë profesor asistent, profesor i asocuar apo profesor i rregullt. Përveç CV-ve janë shqyrtuar edhe listat e publikimeve shkencore për secilin fakultet dhe profesor, të vendosura në uebfaqen e universitetit, në të cilën gjendet një përmbledhje e punës shkencore të stafit akademik e ndarë në katër kategori; Punime të listuara në Google Scholar, Punime Shkencore, Konferenca Shkencore dhe Revista Shkencore. Për arsye të natyrës specifike të tyre, ORCA nuk e ka bërë shqyrtimin e punimeve artistike të cilat kërkohen si kusht ekuivalent i publikimeve shkencore për profesorë nga lëmia e artit. Rrjedhimisht, këta profesorë nuk janë pjesë e këtij raporti.

## PERIUDHA E MBLEDHJES SË MATERIALIT PËR HULUMTIM

Të gjitha CV-të e shqyrtuara, si dhe dokumentet e tjera janë marrë në uebfaqen zyrtare të Universitetit të Mitrovicës<sup>9</sup>, gjatë muajve janar-shkurt 2021. Për arsye të saktësisë së të dhënave, këto CV i janë nënshtruar rishqyrtimit gjatë muajit mars 2021. Të gjitha ndryshimet që janë evidentuar gjatë rishqyrtimit janë aplikuar përshtatshëmrisht në bazën e të dhënave të hulumtimit mbi të cilin është ndërtuar ky raport.

<sup>9</sup> Uebfaqja zyrtare e Universitetit të Mitrovicës, linku: <https://www.umib.net/>



## LLOGARITJA E JUSTIFIKIMIT TË TITUJVE AKADEMIK

Përkundër universiteteve të tjera publike në vendin tonë, Universiteti i Mitrovicës nuk e ka të paraparë me statut apo rregullore që në procesin e avancimit, të vlejë edhe statusi i korrespondencës në një punim shkencor por radhitja si autor i parë.

Për pozitën profesor asistent, kandidatët duhet të kenë të publikuar të paktën një punim shkencor në revista shkencore ndërkombëtare me recension, relevante sipas Statutit të Universitetit të Mitrovicës, si autor të parë. Rrjedhimisht, sipas rregullativave aktuale, koeficientin e publikimeve duhet ta kenë 1.

Për pozitën profesor të asocuar kandidatët duhet të kenë të publikuar të paktën tri punime shkencore në revista shkencore ndërkombëtare relevante, sipas Statutit të Universitetit të Mitrovicës, si autor të parë. Rrjedhimisht, sipas rregullativave aktuale, koeficientin e publikimeve duhet ta kenë 3.

Për pozitën profesor të rregullt, kandidatët duhet të kenë të publikuar të paktën pesë punime shkencore në revista shkencore ndërkombëtare relevante, sipas Statutit të Universitetit të Mitrovicës, si autor të parë. Rrjedhimisht, sipas rregullativave aktuale, koeficientin e publikimeve duhet ta kenë 5.

Duke u bazuar në UA1/2018, UA7/2018 dhe Rregulloren për procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes, avancimit dhe emërimit të personelit akademik në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini", ORCA ka vendosur koeficiente për secilin punim. Këto koeficiente janë vendosur përkatësisht sipas databazave ku janë të indeksuara revistat me koeficientet 1, 0.85 apo 0.70.

ORCA i ka barsvlerësuar me koeficient 0 punimet e publikuara në përmbledhje konferencash, raportet, projektet, librat apo kapituj librash të cilat nuk janë revista shkencore ndërkombëtare, si dhe punimet të cilat janë në proces të publikimit, apo punimet për të cilat autorët kanë marrë çfarëdo konfirmimi nga revista përkatëse, por që nuk janë publikuar.

Publikimet në revista shkencore vendore dhe të vendeve fqinje, bazuar në Udhëzimin Administrativ për parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension janë barsvlerësuar me koeficient 0.

Publikimet në revista të listuara si të dyshimta apo që botuesin e kanë të listuar si të dyshimtë janë barasvlerësuar me koeficient 0 dhe janë numëruar për nevoja të këtij hulumtimi.

## LLOGARITJA E NUMRIT TË PUBLIKIMEVE SHKENCORE

Pas hulumtimit të CV-ve, publikimet shkencore të gjetura në revista sipas rregullativave të përmendura, janë krahasuar mes secilit profesor brenda fakultetit, për të eliminuar dyfishimin e tyre.

Në këtë numër janë përfshirë të gjitha punimet shkencore të botuara në revista valide, si dhe nga analiza e justifikimit të titujve ku janë llogaritur vetëm publikimet në të cilat profesorët e Universitetit të Mitrovicës figurojnë si autorë të parë.



DEKLARATË E MOHIMIT TË PËRGJEGJËSISË:

Ky dokument është përpiluar me ndihmë financiare nga Agjencia Austriake për Zhvillim në kuadër të projektit “Cilësi, Llogaridhënie, Integritet dhe Transparencë në Arsimin e Lartë - QAINT”. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura këtu, në asnjë mënyrë nuk mund ta pasqyrojnë mendimin zyrtar të Agjencisë Austriake për Zhvillim.

With funding from



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë  
Ministërstvo za Obrazovanje, Nauku i Tehnologji  
Ministry of Education, Science and Technology

